



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 188, Datë 25.11.2019

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE” SH.P.K., NR. 262, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 7, DATË 02.02.2015.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma d) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma e); nenit 5, pika 1, gërma e); nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 25.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 111/1 Prot, datë 21.11.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 728 Prot, datë 11.11.2019, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar mbështetur në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datë 27.09.2014 është regjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk), konform ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L42203031A.
- Në bazë të nenit 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, kërkesa për rinovimin e licencës nga aplikanti paraqitet : *Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.*
- Referuar sa më sipër konstatohet se shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k, ka aplikuar brenda afatit ligjor për rinovimin e licencës.
- Aplikimi i shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Neni 9, pika 4.8

- **gërma “b”** (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie)
-Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., ka depozituar në ERE një vërtetim nga Credins Bank, nr. 910 Prot, datë 08.11.2019, ku rezulton se shoqëria është financuar në datën 28.07.2015, me një overdraft, por nuk ka paraqitur sasinë e kapitalit që vë në dispozicion për ushtrimin e veprimtarisë së tregimit të energjisë elektrike.
- **gërma “c”** (Lista e kontratave të mëparshme, të realizuara, nëse ka pasur).
-Shoqëria ka listuar kontrata të mëparshme në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, por nuk ka paraqitur një dokument provues për realizimin e tyre sipas kushteve të kontratës.

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e Energjisë Elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë, nr. 262, Seria T15, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 7, datë 02.02.2015, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI